

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Nga 3.7 e 6.5 milionë që i kanë, gjyqtarët i duan pagat deri 9.9 milionë", ministri Malaj reagon pasi u kall ëzua në SPAK: Zbatova ligjin, janë 40 milionë euro shtesë në vit
ADRESA	https://top-channel.tv/2026/09/10/nga-3-7-e-6-5-milione-qe-i-kane-gjyqtaret-i-duan-pagat-deri-9-9-milione-ministri-malaj-reagon-pasi-u-kallezua-ne-spak-kam-zbatuar-ligjin-jane-40-milione-euro-shtese-ne-vit/
BURIMI	top-channel.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	10 shtator 2026, 17:03:36 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	10 shtator 2026, 17:00:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 10 shtator 2026, 16:59:00 UTC → 10 shtator 2026, 17:01:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5fa9554acee07e65d4c3e170916b47bb4ea02d3175a696cd19cfaab61340cece
TEKSTI	82343300cff4cce37715db0a1b0e157fd68f0d0303c6e8b9c6c7acdb6f7bf175
PAMJA	8d64d6aa9a719a7f1ddb6ff696e5a984bbace84f8a36dae1d356e45093c837d4

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a88a12152d5dfd32583e5c925c032290ecb59a96efb7aeb6ee7e64d24fc75e6d
E MËPARSHMJA	ed3e2fe2fdac376002d1a2e8834b9caee1ea381e3db535c659a75749058f5d85
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a88a12152d5dfd32583e5c925c032290ecb59a96efb7aeb6ee7e64d24fc75e6d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px



- [Lajme](#)
- [Video](#)
- [Sport](#)
- [Pop News](#)
- [Programe](#)
- [Youtube](#)
- [Top News LIVE](#)

Accessibility options



- [Lajme](#)
- [Lajmet e fundit](#)
- [Politikë](#)
- [Kronikë](#)
- [Aktualitet](#)
- [Ekonomi](#)
- [Sociale](#)
- [Video](#)
- [Top News LIVE](#)

- [Bota](#)
- [Opinion](#)
- [Koment](#)
- [Kosova dhe Rajoni](#)
- [Shkencë dhe Teknologji](#)
- [Auto](#)

- [Video](#)
- [Programe](#)
- [Lajme](#)

- [Sport](#)
- [Kombëtarja](#)
- [Kategoria Superiore](#)
- [Kategoria e Parë](#)
- [Premier League](#)
- [La Liga](#)
- [Serie A](#)
- [Shumësportësh](#)
- [Sport Gossip](#)

- [Pop News](#)
- [Showbiz](#)
- [Lifestyle](#)
- [Fashion](#)
- [Shëndeti](#)
- [Dieta](#)
- [Receta gatimi](#)

- [Programe](#)
- [Big Brother VIP](#)
- [Për'puthen](#)
- [Shqipëria LIVE](#)
- [Fiks Fare](#)
- [Video](#)
- [Të gjitha programet](#)
- [Guida TV](#)

- [Top Channel](#)
- [Rreth Top Channel](#)
- [Bileta](#)
- [Kontakt](#)
- [Puno në Top Channel](#)
- [Privacy Policy & Terms of Use](#)
- [Aksesueshmëria](#)

Kërko...

[Aktualitet Kryesore Të Fundit](#)

“Nga 3.7 e 6.5 milionë që i kanë, gjyqtarët i duan pagat deri 9.9 milionë”, ministri Malaj reagon pasi u kallëzua në SPAK: Zbatova ligjin, janë 40 milionë euro shtesë në vit

10/09/2026 19:00



Pas kallëzimit penal të depozituar në SPAK ndaj tij, sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Financave dhe drejtuesve të 16 degëve të Thesarit, ministri i Financave, Petrit Malaj, ka reaguar duke mbrojtur qëndrimin e institucionit për pagesat e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Njëzet nëpunës autorizues të gjykatave në vend, së bashku me kryetarët e Unionit të Gjyqtarëve, Shoqatës Kombëtare të Gjyqtarëve dhe Shoqatës së Prokurorëve, kanë depozituar më 8 shtator kallëzim penal në SPAK, duke kërkuar hetimin e Malajt, Gentian Kërit dhe përgjegjësve të degëve të Thesarit për bllokimin e pagave për muajin gusht.

Në reagimin e tij, Malaj e konsideron situatën si një përshkallëzim të konfliktit mes pushtetit gjyqësor dhe ekzekutivit, ndërsa thotë se Ministria e Financave ka vepruar në përputhje me ligjin.

“Të kallëzohesh sepse po zbaton ligjin, nga garantët e barazisë para ligjit!”, shkruan ministri.

Sipas Malajt, arsyeja e bllokimit lidhet me faktin se Ministria e Financave ka refuzuar të ekzekutojë shtesat e kërkuara të pagave pa një vendim të ri të Parlamentit.

“Ne kemi refuzuar të hapim dyert e thesarit të shtetit për të nxjerrë që aty pa vendim të parlamentit një volum të konsiderueshëm parash, si shtesë rroge për gjyqtarët dhe prokurorët”, shprehet ai.

Ministri thekson se qeveria dhe përfaqësues të Parlamentit kanë deklaruar publikisht se nuk do të pengohet zbatimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese për pagat e magistratëve.

Sipas tij, çështja pritet të adresohet më 17 shtator, kur parashikohet miratimi i ligjit që do t'i japë Ministrisë së Financave kompetencat administrative për veprimin në këtë drejtim.

“Askush nuk do të pengojë adresimin e çështjes së pagave sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Kjo do të ndodhë më 17 shtator, kur të miratohet ligji që i jep Ministrisë së Financave të drejtën administrative të veprimit”, deklaroi Malaj.

Ai shprehet se, pavarësisht kësaj, përfaqësuesit e pushtetit gjyqësor kanë zgjedhur të përshkallëzojnë përplasjen përmes kallëzimit penal.

Deklarata e plotë e Malajt:

Të kallëzohesh sepse po zbaton ligjin, nga garantët e barazisë para ligjit!

Sot, në Ministrinë e Financave u depozitua një kallëzim penal për mua si titullar i institucionit, Sekretarin e Përgjithshëm dhe drejtorët e thesarit në të gjithë Shqipërinë.

Arsyeja: Kemi refuzuar të hapim dyert e thesarit të shtetit për të nxjerrë që aty pa vendim të parlamentit një volum të konsiderueshëm parash, si shtesë rroge për gjyqtarët dhe prokurorët.

Nuk dua të bëj asnjë polemikë me askënd dhe as të risqaroj pozicionin e Ministrisë së Financave, ndërkohë që është thënë publikisht nga qeveria shqiptare dhe përfaqësuesit e Parlamentit, se askush nuk do të pengojë adresimin e çështjes së pagave sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Kjo do të ndodhë më 17 shtator, kur të miratohet ligji që i jep Ministrisë së Financave të drejtën administrative të veprimit.

Por, kjo nuk i ka penguar përfaqësuesit e pushtetit gjyqësor që të përshkallëzojnë konfliktin me ekzekutivin duke nënshkruar një kallëzim penal që do ta marrë me siguri historia.

Ndërkohë unë sot dua t'u bëj me dije qytetarëve sa kushton kërkesa e kallzuesve të nderuar, sipas shkallës së pagave:

Gjyqtar i Shkallës së Parë

Është: 376, 381 Lekë

Kërkohet: 567,421 Lekë

Gjyqtar i Shkallës së Dytë

Është: 388,927 Lekë

Kërkohet: 586,335 Lekë

Gjyqtar i Grupit të III në GJKKO

Është: 659,920 Lekë

Kërkohet: 994,877 Lekë

Efekti total në buxhetin e shtetit me këto kërkesa është 40 milionë euro shtesë, çdo vit. Por nuk mbyllet këtu.

Magjistratët kërkojnë rishikim të pagave për periudhën 2023-2026 me një efekt në buxhetin e shtetit 125 milionë euro.

Ndërkohë u them drejtoreshë të Thesarit në të gjithë Shqipërinë dhe Sekretarit të Përgjithshëm, që sot u kallëzuan së bashku me mua, se duhet të vazhdojnë ta kryejnë detyrën e tyre me qetësi dhe pa u intimiduar, duke ruajtur gjithmonë me rigorozitet financat e shtetit, të udhëhequr nga ligji.

Top Channel

[Aktualitet »](#)

["Ndryshimi i ligjeve nuk mjafton"/ Ambasadori gjerman në Shqipëri për DW: Reforma në drejtësi dhe goditja e korrupsionit, faktorë kyç për në BE 10/09 18:38](#)

[Alarm në Mallakastër, rindizet zjarri në Çerrilë/ Flakët përfshijnë sipërfaqe me pisha 10/09 18:17](#)

[Bllokimi i pagave të Drejtësisë, kryetarët e gjykatave kallëzojnë në SPAK ministrin e Financave, Petrit Malaj dhe 16 drejtues të Thesarit. Rama: Më shtoni dhe mua! 10/09 17:55](#)

["Rama më shkruan edhe në 12 apo 1 të natës"/ Dashnor Sula në "Shqipëria Live": Nga skema me mishin te kontrollet e karburanteve 10/09 17:26](#)

[Aksident në aksin Berat-Lushnjë/ Tre automjete përplasen me njëra-tjetrën, dy persona në gjendje të rëndë 10/09 16:56](#)

["Shko dhe përballu me drejtësinë", sekuestrimi i vilës në Palasë, Kapri në "Shqipëria Live": Nëse SPAK na kërkon heqjen e imunitetit për Ballukun, ne e japim votën pro Kryesore »](#)

["Ndryshimi i ligjeve nuk mjafton"/ Ambasadori gjerman në Shqipëri për DW: Reforma në drejtësi dhe goditja e korrupsionit, faktorë kyç për në BE 10/09 18:38](#)

["Jam princesha jote e vogël, të dua"/ I dërgonte foto dhe video intime të dënuarit për vrasje, oficerja 23-vjeçare i shpëton burgut 10/09 18:03](#)

[Bllokimi i pagave të Drejtësisë, kryetarët e gjykatave kallëzojnë në SPAK ministrin e Financave, Petrit Malaj dhe 16 drejtues të Thesarit. Rama: Më shtoni dhe mua! 10/09 17:55](#)

[Trump premtoi 5 mijë dollarë për çdo amerikan nëse republikanët fitojnë zgjedhjet e nëntorit, sa i ligjshëm është shpërblimi që garanton presidenti nëse triumfon? 10/09 17:39](#)

["Rama më shkruan edhe në 12 apo 1 të natës"/ Dashnor Sula në "Shqipëria Live": Nga skema me mishin te kontrollet e karburanteve 10/09 17:26](#)

[Vrau shqiptarin dhe e dogji brenda makinës, merr kthesë krimi makabër, familja në agoni pas detajeve të reja 10/09 17:10](#)

Na ndiqni:

[Top Channel @topchannelalbania @tchbreakingnews Top Channel](#)

[Video »](#)

[Top News – 'Do të zgjasë edhe disa muaj', Trump: Lufta me Iranin nuk përfundon shpejt](#)

[Top News- 'Zhbllokoni pagat, ose bllokojmë gjyqet', gjyqtarët deklaroi: Kushtetuta nuk negociohet](#)

[Top Channel/ Aksident në aksin Berat-Lushnjë, përplasen 3 automjete, 2 persona në gjendje të rëndë](#)

[Top News – 'Eksperiment me shumë viktime,' Rama: Tirana po paguan mbajtjen e Veliajt në burg](#)

[Top News – Programi i strehimit social, Rama premton: Mbështesim 50 mijë familje deri në 2030](#)

[Top News – Gushti më përvëlues në histori. Muaji 'i flaktë', temperaturat kaluan pikën kritike](#)

[Kryesore](#)

["Ndryshimi i ligjeve nuk mjafton"/ Ambasadori gjerman në Shqipëri për DW: Reforma në drejtësi dhe goditja e korrupsionit, faktorë kyç për në BE 18:38](#)

[Protesta në fushën naftëmbajtëse Patos-Marinëz nis me tensione, banorët hyjnë në ambientet e Bankers Petroleum 08:56](#)

[Kontrolle në Lezhë, bllokohet 'bisha' "Rolls-Royce", nis hetimi pasuror për pronarin 11:35](#)

["Ngushticës së Hormuzit do t'i vë emrin tim"/ Premtimi i ri i Trumpit: Pesë mijë dollarë për çdo amerikan të rritur nëse fitojmë zgjedhjet e mesmandatit 07:37](#)

[Transferimi më i shtrënjtë në historinë e Real Madridit, por Diomande ende nuk ka debutuar si titullar 09:44](#)

[Më të lexuarat](#)

[Vrau shqiptarin dhe e dogji brenda makinës, merr kthesë krimi makabër, familja në agoni pas detajeve të reja](#)

["Jam princesha jote e vogël, të dua"/ I dërgonte foto dhe video intime të dënuarit për vrasje, oficerja 23-vjeçare i shpëton burgut](#)
[Kontrolle në Lezhë, bllokohet 'bisha' "Rolls-Royce", nis hetimi pasuror për pronarin](#)
["Pesë mijë dollarë për çdo amerikan të rritur nëse fitojmë zgjedhjet e mesmandatit"/ Vance: Tarifat nuk mjaftojnë për premtimin e Presidentit](#)
[Gjyqi në Hagë, Prokuroria kërkon dënim me 6 vjet burgim për Thaçin, zbardhet akuza](#)
[Sot gjyqi në Hagë, Prokuroria: Thaçi tentoi ta pengonte procesin gjyqësor duke ndikuar te dëshmitarët](#)
["Shumë shpejt do i japim fund historisë së pajustificueshme të rindërtimit", Rama me tone të ashpra për Veliajn: Prerja e kokës së kryeqytetit, eksperimenti më i rëndë social](#)
[Zbehet "ëndrra europiane"/ Kontinenti i vjetër nuk është më i lakmueshëm, bien me 17% kërkesat për azil në BE](#)
[I mori jetën 13-vjeçares shqiptare duke e hedhur nga ballkoni, gjykata jep vendimin e papritur për vrasësin e Aurora Tilës](#)
["Ngushticës së Hormuzit do t'i vë emrin tim"/ Premtimi i ri i Trumpit: Pesë mijë dollarë për çdo amerikan të rritur nëse fitojmë zgjedhjet e mesmandatit](#)

- [Lajme](#)
- [Lajmet e fundit](#)
- [Politikë](#)
- [Kronikë](#)
- [Aktualitet](#)
- [Ekonomi](#)
- [Sociale](#)
- [Video](#)
- [Top News LIVE](#)

- [Bota](#)
- [Opinion](#)
- [Koment](#)
- [Kosova dhe Rajoni](#)
- [Shkencë dhe Teknologji](#)
- [Auto](#)

- [Sport](#)
- [Kombëtarja](#)
- [Kategoria Superiore](#)
- [Kategoria e Parë](#)
- [Premier League](#)
- [La Liga](#)
- [Serie A](#)
- [Shumësportësh](#)
- [Sport Gossip](#)

- [Pop News](#)
- [Showbiz](#)
- [Lifestyle](#)
- [Fashion](#)
- [Shëndeti](#)
- [Dieta](#)
- [Receta gatimi](#)

- [Programe](#)
- [Big Brother VIP](#)
- [Për'puthen](#)
- [Shqipëria LIVE](#)
- [Fiks Fare](#)
- [Video](#)
- [Të gjitha programet](#)
- [Guida TV](#)

- [Top Channel](#)
- [Rreth Top Channel](#)
- [Bileta](#)
- [Kontakt](#)
- [Puno në Top Channel](#)
- [Privacy Policy & Terms of Use](#)
- [Aksesueshmëria](#)

© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.